

Sektor i veprave civile pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar për çështjen juridike me interes për zbatimin unik të së drejtës dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 15.05.2023, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Palës i takojnë shpenzime në emër të kompensimit për ekspertizën e përgatitur edhe krahas asaj që nuk është dorëzuar dëshmi që është paguar për ekspertizën e përgatitur.

A r s y e t i m

Në Takimin punues të sektorëve civil të katër gjykatave të apelit, të mbajtur më 06.10.2021, është diskutuar çështja juridike nëse palës i takojnë shpenzime për ekspertizën e përgatitur në kushte kur pala në shtojcë të padisë ose përgjigjes së padisë nuk dorëzon dëshmi që është paguar ekspertiza por bashkëngjijt faturën e përgatitur nga personi ekspert. Duke qenë se nuk janë përputhur mendimet e katër gjykatave të apelit, është përfunduar se çështja juridike duhet të shqyrtohet dhe për të njëjtën duhet të deklarohet Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke diskutuar mbi çështjen e parashtruar juridike, miratoi mendimin juridik për këto arsye:

Sipas nenit 145 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë kontestimore, shpenzimet kontestimore i përbëjnë shpenzimet e bëra gjatë procedurës ose me rastin e procedurës.

Sipas nenit 148 paragrafi (1), pala e cila në tërësi do të humb kontestin, është e detyruar që palës së kundërt dhe ndërhyrësit t'ua kompensojë shpenzimet.

Sipas nenit 149 paragrafi (1) nga i njëjti ligj, gjatë vendosjes se cilat shpenzime do t'i kompensohen palës, gjykata do t'i marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për mbajtjen e kontestit. Për atë se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe për lartësinë e shpenzimeve, vendos gjykata, duke i vlerësuar me kujdes të gjitha rrethanat. Sipas paragrafit (2) nga i njëjti nen, shpërblimi dhe shpenzimet tjera të avokatëve maten sipas tarifës për kompensimin e shpenzimeve të avokatëve.

Në kuptim të dispozitës nga neni 241 paragrafi (1) nga i njëjti ligj, në mes tjerash, eksperti ka të drejtë të shpërblimit për ekspertizën e bërë.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara të Ligjit për procedurë kontestimore, rezulton se personi ekspert ka të drejtë të shpërblimit për ekspertizën e bërë,

ndërsa pala e cila në tërësi do të humb kontestin është e detyrueshme që t'ia kompensojë palës së kundërt ndër shpenzimet tjera edhe shpenzimet për ekspertizën e bërë.

Personi ekspert për shërbimin e kryer lëshon faturën e cila është bazë për kërkesën e shumës që përfshihet në të nga porositësi i shërbimit. Në atë mënyrë formohet marrëdhënia-detyruese-juridike në mes tyre që realizohet sipas dispozitave të Ligjit për marrëdhënie obliguese. Rrethana nëse pala-porositësi i ekspertizës e ka paguar mendimin dhe konstatimin ekspert të përgatitur nuk është me kuptim relevant për gjykatën gjatë shqiptimit të shpenzimeve të procedurës në emër të ekspertizës, për shkak se është marrëdhënia në mes të dy palëve të kontraktuar me të cilët është rregulluar mënyra, kushtet dhe afatet e pagesës për shërbimin e kryer.

Kjo aq më tepër që gjykata edhe lidhur me shpenzimet për përbërjen e parashtresave dhe përfaqësimin e palës nga avokati, i shqipton shpenzimet e palës që ka arritur në kontest pavarësisht nëse ato shpenzime ajo ia ka kompensuar dhënësit të shërbimit-avokatit, përkatësisht pa dëshmi nga pala se shërbimi i është paguar avokatit.

Duke marrë parasysh të së ekspozuarën, palës i takojnë shpenzime në emër të kompensimit për ekspertizën e përgatitur edhe krahas asaj që nuk është dorëzuar dëshmi se është paguar për ekspertizën e bërë, nëse merret parasysh se për ekspertizën e përgatitur, personi juridik ose personi ekspert lëshon faturë, me të cilën e detyron porositësin që t'i paguajë për punën me çka krijohet një marrëdhënie tjetër detyruese juridike.